



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 149, Datë 28.06.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“DON – UCD” SH.P.K., PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DON – UCD” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 475 datë 27.06.2018, shoqëria “DON - UCD“ sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “DON - UCB” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8, gërmat “b” dhe “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 4.8, gërma ”a” (sasia e energjisë elektrike të parashikuar për tu tregtuar), do ti kërkohet subjektit që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për Proçedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, që ti paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DON – UCD” sh.p.k, për licencim në të aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.